

BASHKIA ELBASAN
NJOFTIMI I FITUESIT

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga "Qemal Stafa", Elbasan

Për: **"Bajrami N" sh.p.k.** me adrese: Lagja "Qemal Stafa", pallati pranë furrës së Xhevatit, kati i I-rë, Elbasan.

Për: **"Blerimi" sh.p.k.** me adrese: Fshati Mjekës, rruga Elbasan – Cerrik, km 4-t, Komuna Shirgjan Elbasan.

Procedura e prokurimit: **"Procedure e Hapur"**.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **"Rikualifikim urban i parkut "Aqif Pasha"** me fond limit: **91.541.156** (nëntëdhjetë e njëmilion e pesëqind e dyzet e njëmije e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **leke (pa TVSH)**, nga ku vlera për financim **për vitin 2015** është **61.612.867** (gjashtëdhjetë e njëmilion e gjashtëqind e dymbëdhjetemijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) **lekë (pa TVSH)** dhe me afat për përfundimin e punimeve **90 ditë nga data e lidhjes së kontratës**.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [20.10.2015] [41]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedure këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. "Bajrami N" sh.p.k. me Nipt: K 02727202 O & **"Blerimi" sh.p.k.** me Nipt: J 62903384 G

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit **79.610.600** (shtatëdhjetë e nëntëmilion e gjashtëqind e dhjetëmijë e gjashtëqind) **lekë (pa TVSH)** dhe me vlerë kontrate prej **95.532.720** (nëntëdhjetë e pesëmilion e pesëqind e tridhjet e dymijë e shtatëqind e njëzet) **lekë (me TVSH)**.

2. "Sireta 2 F" sh.p.k. me Nipt: K 51501008 J & **"Alko Impex General Construction "** sh.p.k me Nipt: K 91326028 I.

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit **74.444.444** (shtatëdhjetë e katërmilion e katërqind e dyzet e katërmijë e katërqind e dyzet e katër) **lekë (pa TVSH)** dhe me vlerë kontrate prej **89.333.333** (tetëdhjetë e nëntëmilion e treqind e tridhjet e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë (me TVSH)**.

3. "Victoria Invest" sh.p.k. me Nipt: K 32712206 U & **"AL-Asfalt" sh.p.k.** me Nipt: K 81511508 A

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit **82.174.998,5** (tetëdhjetë e dymilion e njëqind e shtatëdhjetë e katërmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë presje pesë) **lekë (pa TVSH)** dhe me vlerë kontrate prej **98.609.998,2** (nëntëdhjetë e tetëmilion e gjashtëqind e nëntëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë presje dy) **lekë (me TVSH)**.

Ofertues i skualifikuar një operator.

-Ofertuesi “ Sireta 2 F ” sh.p.k. & “Alko Impex General Construction ” sh.p.k.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1-Ofertuesi “Sireta 2 F” sh.p.k. & “Alko Impex General Construcion ” sh.p.k skualifikohet per arsye se: **Kishte mangësi ne dokumentacionin** e paraqitur pasi, i mungon nje pjese e dokumentacionit ligjor, teknik te kerkuar ne dokumentat standarte.

Operatori ekonomik Alko-Impex General Construction” sh.p.k në Kosovë nuk ka paraqitur vertetim, nga institucioni perkates, per shlyerjen e taksave vendore, per vendet e ushtrimit te aktivitetit ne Kosove.

Operatori ekonomik Alko-Impex General Construction” sh.p.k në Kosovë nuk ka paraqitur një dokument që vërteton se i ka plotësuar detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Administrata Tatimore.

Operatori ekonomik Alko-Impex General Construction” sh.p.k në Kosovë ne lidhje me kriterin përvojë e suksesshme në ekzekutimin e shërbime të së njëjtës natyrë të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të tij ka paraqitur dy kontrata:

- Rikonstrukcion i rruges Komsji –Burrel për të cilën nuk ka paraqitur aktin e kolaudimit të kërkuar në DST.
- Rruga nacionale Prishtine –Mutivode nuk eshte e shoqeruar me formularë vlerësimi dhe kontrata nuk eshte e firmosur ne cdo faqe nga palët kontraktuese.

Operatori ekonomik Alko-Impex General Construction” sh.p.k dega, ka paraqitur listpagesat e punonjësve të pa konfirmuara nga Administrata Tatimore si dhe formularët e deklarimit te kontributeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetsore (FDP), formularët e deklarimit te te ardhurave nga punesimi (TAP) si dhe mandat pagesat per FDP dhe TAP nuk janë paraqitur për cdo muaj të periudhës së kërkuar në DST.

Operatori ekonomik Alko-Impex General Construction” sh.p.k ne Kosove për të përmbushur kriterin punonjes elektrikist, hidraulik dhe saldator me kualifikime teknike nga IQT ka paraqitur vetëm kontrata pune shoqëruar me deklaratën se në Kosove nuk aplikohet ky vërtetim, por nuk ka paraqitur asnje dokument që vërteton se këta persona të kontraktuar janë të specialiteteve përkatëse të kërkuara.

Operatori ekonomik Sireta 2F në vërtetimin e paraqitur , për shlyerjen e detyrimve te matuara të energjisë, nuk përfshihet muaji Shtator , te cilin cdo konsumator duhet ta shlyej brenda datës 28 te muajit pasardhës. Për rrjedhojë rezulton që operatori ekonomik të rezultoj debitor.

Operatori ekonomik Sireta 2F Ne lidhje me kriterin përvojë e suksesshme në ekzekutimin e shërbime të së njëjtës natyrë të realizuara gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të tij ka paraqitur disa kontrata të cilat nuk shoqerohen me aktin e marrjes ne dorëzim. Gjithashtu kontrata për rrugën ”Llazar Shapatini”, e cila përvec faktit se nuk është e shoqëruar me aktin e marrjes në dorëzim të kërkuar në DST, nuk është e firmosur në cdo fletë nga palët kontraktuese.

Operatori ekonomik Sireta 2F ka paraqitur listpagesat e punonjësve të vitit 2012 të pa konfirmuara nga Administrata Tatimore.

Drejtues Teknik i punimeve Marie Ukcama Ing. Ndërtimi që Sireta 2F ka përcaktuar me ane te nje deklarate si Drejtues Teknik te punimeve ne objekt nuk është e perfshirë në licensen e shoqerise .

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin, bashkimin e shoqërive, **“Bajrami N” sh.p.k.** me adresë: Lagja “Qemal Stafa”, pallati pranë furrës së Xhevatit, kati i I rë, Elbasan & **“Blerimi” sh.p.k.** me adrese: Fshati Mjebes, rruga Elbasan – Cerrik, km 4-t, Komuna Shirgjan Elbasan, se oferta e paraqitur prej tyre, me një vlerë të përgjithshme prej **79.610.600** (shtatëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dhjetë mijë e gjashtëqind) **lekë** (pa TVSH) është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkise Elbasan (Sektori i Prokurimeve)**, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda **20** (njëzet) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **82.174.998,5** (tetëdhjetë e dymilion e njëqind e shtatëdhjetë e katërmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë presje pesë) **lekë** (pa TVSH), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 18.11.2015 Ankesa nuk ka patur.

